

# Çfarë duhet t'i tregoni Centrelink-ut



We speak your language 📞 13 1202

Things to tell Centrelink - Albanian

Në se ju merrni pagesë prej Centrelink-ut, ju duhet që ta informoni zyrën e Centrelink-ut në lidhje me të ardhurat tuaja monetare dhe në se ka ndonjë ndryshim në rrethanat tuaja personale. Kjo bëhet që ju të merrni sasinë e duhur të pagesës.

Në letrat që merrni nga Centrelink-u shënohen të gjitha informacionet që duhet të na jepni. Në se nuk e kuptoni informacionin që përmban letra, telefononi tek 13 1202.

Disa nga informacionet që duhet të na jepni janë:

- Në se ju ose bashkëshorti juaj nisni punë dhe sa paguheni (përfshi taksën)
- Në se sasia e orëve të punës për ju ose bashkëshortin tuaj ndryshon
- Në se martoheni, nisni një jetoni në një marrëdhënie të ngjashme me martesën, ndaheni ose pajtoheni
- Në se ndërtoni adresë
- Në se ndryshon sasia e qirasë që paguani
- Në se largoheni nga Australia përkohësisht ose përgjithmonë, **dhe**
- Në se ndërpreni ose nisni që të përkujdeseni për fëmijët tuaj.

**Shënim:** Ju lutemi që të ruani të gjitha fletë-pagesat e rrogës suaj dhe t'ja jepni Centrelink-ut në se ju kërkohen.

## Si të informoni Centrelink-un?

- Duke telefonuar në **13 1202**
- Duke shkuar në një takim me zyrën tuaj lokale

- Duke na dërguar formularët e plotësuar që ju dërgojmë, **ose**
- Duke na dërguar një letër.

## Kur duhet t'a informoni Centrelink-un?

- Kur filloni që të merrni pagesa nga puna, **dhe**
- Menjëherë sapo të ndryshojnë rrethanat tuaja.

**Në se ju ose bashkëshorti juaj nuk na informoni ashtu siç duhet në lidhje me këto ndryshime, atëherë:**

- Pagesa juaj mund të ndërpritet ose të vonohet, **dhe/ose**
- Mund t'ju kërkohet që të ktheni të hollat që keni marrë në rast se jeni paguar më shumë se duhet **dhe/ose**
- Në disa raste mund t'ju kërkohet që të paguani një tarifë shtesë për shpenzimet e tërheqjes së të hollave.

## Disa këshilla:

- Kontaktoni Centrelink-un në se nuk jeni të sigurt për ato që duhet të na tregoni.
- Kur na kontaktoni, është më e lehtë në se mund të na tregoni Centrelink Reference Number (Numrin e Personal të Centrelink-ut). Këtë numër mund t'a gjeni në letrat tona.
- Ju mund t'i jepni Centrelink-ut leje që një person tjetër të jetë në gjendje të na informojë në emrin tuaj. Por është detyra juaj që të siguroheni që

[www.centrelink.gov.au](http://www.centrelink.gov.au)



Australian Government



MCC0256ALB.0608 (page 1 of 2)

Centrelink-u e ka marrë dhe ka vepruar sipas informacionit tuaj.

- Merrni pjesë në seminarët informative të Centrelink-ut për të mësuar më shumë për të drejtat dhe detyrat tuaja.
- Lexoni broshurat që gjenden nëpër zyrat tona, si për shembull *'Going Overseas?' (Kur udhëtoni jashtë Australisë?)*.

Për të folur në gjuhën Shqipe me Centrelink-un, telefononi në numrin **13 1202\***.  
Informacioni në gjuhën tuaj gjendet edhe në adresën e internetit **[www.centrelink.gov.au](http://www.centrelink.gov.au)**

\* Thirrjet me numrat që fillojnë me "13" nga një shërbim standard telefonik mund të bëhen prej kudo në Australi për jo më shumë se kostoja e një thirrje lokale (çmimi për thirrje mund të ndryshojë në varësi kompanisë së telefonit që ju siguron shërbimin telefonik). Thirrjet me numrat "1800" janë falas. Çmimet për thirrjet nga telefonat publikë dhe celularët mund të jenë më të larta.